

Programi vi: Kapitali njerëzor për rritjen e qendrueshme

Si përgjigje për sigurimin e zhvillimit të kapitalit njerëzor Grupi Barleti dhe UniBA kanë krijuar iniciativën AM-Barleti Human Capital. Kjo nismë mbështetet mbi disa vlera thelbësore si: promovimi i standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare të cilësisë në tregun e punës, krijimin e një mjedisi dinamik dhe konkurrues. Ajo sznon të nxitë zhvillimin në nivel individual, profesional dhe komunitar duke pasur në fokus punësimin, fuqizimin e kapitalit njerëzor - mbështetjen për sipërmarrjen si dhe përputhjen e aftësive me talentet dhe me kërkesat e çdo punëmarrësi dhe punëkërkuesi.

Hyrje

Individët dhe kapitali njerëzor që ata përfaqësojnë janë baza e një shoqërie demokratike dhe e një ekonomie të qendrueshme. Adam Smith në kryeveprën e tij “Pasuria e kombeve” në 1776 pohonte se: *“një njeri i arsimuar me çmimin e harxhimit të një pune dhe të një periudhe kohore për çdo veprimtari, e cila kërkon një aftësi të jashtëzakonshme dhe kualifikim të mirë duhet të krahasohet me një makinë të shtrenjtë. Puna që ai mëson të kryejë pritet të shpërblehet mbi pagat e zakonshme për punët e zakonshme dhe kështu i kthehen mbrapsht jo vetëm shpenzimet e bëra për arsimim por edhe së paku një përfitim mesatar për një formë ekuivalente kapitali”*. Ndër vite është pohuar dhe rikonfirmuar se kapitali më i vlefshëm është ai i investuar në njerëz.

Duhet pasur parasysh që kapitali njerëzor nuk është gjithmonë homogjen dhe kjo për minimum dy arsye kryesore:

- Ndodhet në posedimin e disa individëve që zotërojnë kompetenca të ndryshme të specializuara apo mjeshtëri profesionale të veçanta;
- Dëshira për të punuar e reflektuar në intensitetin e punës nga njëra anë dhe koha e domosdoshme për punën e bërë nga ana tjetër, ndryshon në funksion të mjedisit kulturor apo mundësisë për të siguruar të ardhura nga burime të tjera.

Rëndësia e madhe që paraqet për të ardhmen e njerëzimit zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe përditësimi i aftësive të tij, ka një vemendje të veçantë nga Komisioni Evropian duke hartuar strategji të posaçme si *Research and Innovation Strategies for Smart Specialisations (RIS 3)*[1]. Bashkimi Evropian e sheh zhvillimin dhe fuqizimin e kapitalit njerëzor si mekanizmin kryesor për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të çdo rajoni, përkrah zhvillimeve teknologjike, kërkimit shkencor dhe zhvillimeve në infrastrukturë.

Modele të ndryshme zhvillimi aplikohen aktualisht për të zhvilluar dhe fuqizuar kapitalin njerëzor me qëllim sigurimin e një rritje të qendrueshme. Një ndër këta modele i aplikuar edhe nga Barleti Group është modeli 5 dimensional – Quintuple Helix i inicuar nga Carayannis EG, dhe Campbell DFJ i cili synon krijimin e një ekosistemi gjithëpërfshirës midis akademisë (universiteteve), bizneseve, industrive, qeverisë, profesionistëve dhe komunitetit duke gjeneruar



forma të reja bashkëpunimi institucionale dhe shoqërore për prodhimin, transferimin dhe aplikimin e njohurive.

Përkufizimi i kapitalit njerëzor

Kapitali njerëzor, përfaqëson burimet e paprekshme kolektive të zotëruara nga individë dhe grupe brenda një popullate të caktuar. Këto burime përfshijnë të gjitha njohuritë, talentet, aftësitë, përvojën, inteligjencën, trajnimin, stërvitjen, gjykimin dhe mençurinë e zotëruar individualisht dhe kolektivisht, shumatorja e së cilës përfaqëson një formë të pasurisë në dispozicion të kombeve dhe organizatave për të përmbushur qëllimet e tyre[2].

Kapitali njerëzor është i disponueshëm për të gjeneruar pasuri materiale për një ekonomi ose një firmë private. Në një organizatë publike, kapitali njerëzor është në dispozicion si një burim për të siguruar mirëqenien publike. Se si zhvillohet dhe menaxhohet kapitali njerëzor mund të jetë një nga përcaktuesit më të rëndësishëm të performancës ekonomike dhe organizative.

Lidhja midis kapitalit njerëzor dhe rritjes së qendrueshme është në proporcion të drejtë. Investimi në kapitalin njerëzor është investimi më i sigurt dhe afatgjatë dhe trashëgimia më e vlefshme që mund t'i lihet brezave të ardhshëm. Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm prej kohësh është fjala kyçe e preferuar në qarqet e zhvillimit. Zakonisht lidhet si koncept me qëndrueshmërinë financiare, pasuritë afatgjata ose pasuritë fizike. Duhet të jetë më shumë se kaq. Banka Botërore nisi Projektin e Kapitalit Njerëzor në 2017, duke bërë një bast të madh me njerëzit me qëllim rritjen dhe përditësimin e njohurive të gjeneratës së ardhshme të rritjes. Infrastruktura dhe teknologjia përparojnë, por ky progres mund të jetë në dobi të njerëzimit vetëm nëse njerëzit janë në gjendje ta drejtojnë atë.

Si përgjigje për sigurimin e zhvillimit të kapitalit njerëzor Grupi Barleti dhe UniBA kanë krijuar iniciativën AM-Barleti Human Capital. Kjo nismë mbështetet mbi disa vlera thelbësore si: promovimi i standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare të cilësisë në tregun e punës, krijimin e një mjedisi dinamik dhe konkurrues. Ajo shpesh të nxitë zhvillimin në nivel individual, profesional dhe komunitar duke pasur në fokus punësimin, fuqizimin e kapitalit njerëzor - mbështetjen për sipërmarrjen si dhe përputhjen e aftësive me talentet dhe me kërkesat e çdo punëmarrësi dhe punëkërkuessi.

Aspektet e zhvillimit të qëndrueshëm të kapitalit njerëzor

Ekuacioni kapital njerëzor – rritje e qendrueshme në dukje përfshin vetëm një kah, në kontributin që sjell kapitali njerëzor në rritjen e qendrueshme ekonomike, por në fakt shumë mirë qendron dhe e ansjellta, pra zhvillimi i qëndrueshëm i kapitalit njerëzor.

Aspektet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm të kapitalit njerëzor janë:

1. *Fuqizimi* – përhapja dhe zgjerimi i aftësive dhe mundësisve të zgjedhjes, rrit mundësinë e individëve të ushtrojnë zgjedhjet e tyre lirshëm me dëshirë dhe pa u privuar. Po ashtu rrit mundësinë e individëve për të marrë pjesë në vendimmarrje që ndikojnë jetët e tyre.



2. *Bashkëpunimi* – me një sens përkatësie ndaj përsosjes personale, mirëqenies dhe mirëkuptimit, zhvillimi i kapitalit njerëzor lidhet me mënyrën si njerëzit ndërveprojnë dhe punojnë së bashku.
3. *Barazia* - Zgjerimi i aftësive dhe mundësive do të thotë më shumë sesa të ardhura – kjo gjithashtu nënkupton barazi, siç është një sistem arsimor, të cilin duhet të kenë të gjithë akses.
4. *Qendrueshmëria* - nevojat e kësaj gjenerate duhet të përmbushen pa cenuar të drejtat e gjeneratave të ardhshme të jenë të lirë nga varfëria dhe ushtrimi i aftësive të tyre themelore.
5. *Siguria* – veçanërisht sitgura e jetës. Njerëzit duhet të çlirohen nga kërcënimet siç janë sëmundja, apo ndërprejet apo pasiguritë e papritura në jetën e tyre.

Rëndësia e programit kushtuar kapitalit njerëzor dhe rritjes së qendrueshme

Zhvillimet e reja të ekonomisë, që kanë orientuar kalimin e tyre në ekonomi të bazuara në dije, në ekonomi globale dhe ekonomi në zhvillim, së bashku me sfidat shoqërore si qëndrueshmëria mjedisore dhe plakja e popullsisë, e kanë ndryshuar krejtësisht natyrën e punës. Ato gjithnjë e më shumë çojnë në një nevojë kritike për një bazë të gjallë, krijuese dhe inovative të kapitalit njerëzor.

Tregu i punës është në zhvillim të vazhdueshëm. Nuk është më e mjaftueshme t'i trajnosh studentët për një karrierë sepse aftësitë, kompetencat dhe kualifikimet që njerëzit kanë nevojë, ndryshojnë me kalimin e kohës. Institucionet e formimit dhe të kualifikimit në arsim duhet t'i përgatisin studentët dhe të rriturit për të punuar në një mjedis dinamik, në ndryshim të shpejtë, sipërmarrës dhe global. Për t'u marrë me këto ndryshime, sistemi arsimor ka nevojë të përmirësojë qasjet e tij në mënyrë që të jetë në gjendje të pajisë njerëzit me aftësi dhe kualifikime të reja, të nevojshme në tregun e sotëm të punës dhe, akoma më shumë, në ekonominë globale të ditës së nesërme. Institucionet e formimit dhe të kualifikimit në arsim duhet t'u mundësojnë të gjithë qytetarëve të fitojnë dhe zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për punësimin e tyre dhe të nxisin të nxënë të mëtejshëm, qytetarinë aktive dhe dialogun ndërkulturor.

Grupi Barleti dhe UniBA, nëpërmjet AM-BARLETI HUMAN CAPITAL ofrojnë shërbimet kryesore që mundësojnë përditësimin dhe fuqizimin e aftësive dhe kompetencave si dhe kualifikimin e trajnimit për gjatë gjithë jetës.

Partneriteti helika e pesëfishtë (quintuple helix)

- Nxënës/ studentë – mësues/pedagogë – prindër/komunitet
- Universiteti Barleti
- Grupe interesi (juristë, sociologë, ekonomistë etj)



- Barleti professional Academy
- Shoqëria civile
- Sipërmarrje dhe biznese
- Institucione shtetërore politikëbërëse dhe zbatuese
- BARLETI HUMAN CAPITAL
- Donatorë të ndryshëm

MODALITETET E ZBATIMIT TË PROGRAMIT:

- Orientim dhe këshillim karriere
- Konsulencë;
- Ofrim të një pakete të gjerë trajnimesh për forcimin e aftësive soft;
- Implementimi i programeve që fuqizojnë aftësitë e individëve duke i përshtatur për tregun e punës, siguruar kohezionin social dhe ndaluar emigrimin e krahur të punës;
- Shërbime si agjenci punësimi; agjenci rekrutimi; institute për zhvillimin e burimeve njerëzore; nxitjen dhe ndërmjetësimin e punësimit;
- Zhvillim Kapacitetesh;
- Organizim i konferencave, trajnimeve, work shop-eve dhe internshipeve.

Target grupet:

- Fëmijët e arsimit parshkollor
- Nxënësit; Gjymnazistët dhe nxënësit e shkollave profesionale
- Studentët
- Mësues/pedagogë
- Drejtues shkollash/ politikbërës nga institucionet publike
- Institucionet shtetërore: Shërbimi kombëtar i punësimit
- Emigrantë, imigrantë
- Kategoritë vulnerabël
- Personat me aftësi ndryshe
- Bizneset dhe sipërmarrjet
- Lobuesit (OJF) për nxitjen e punësimit
- Mjeshtërat/artizanët
- Të vetëpunësuarit
- Punëdhënës;
- Punëkërkuar/ punonjës/ teknikë/ menaxherë/ ekspertë.

Linjat e veprimit të programit dhe fjalë kyçe



1. **Shërbime agjencie punësimi:** përputhja e punëdhënësit me punëmarrësin; përputhja e talentit me punëmn; rekrutimi dhe promovimi i karrierës; këshillimi i karrierës; riintegrimi në tregun e punës; praktika profesionale dhe internshipe; ndërmjetësim për punësim.
2. **Shërbime rekrutimi profesionistësh:** identifikimi dhe rekrutimi i profesionistëve; gjenerimi i profesionistëve; shërbime kompanie stafesh; qarkullimi i ekspertëve me anë të “brain circulation”; stafleasing.
3. **Akademia e trajnimit dhe aftësive:** - këshillim dhe udhëzim për punëkërkuessit; ritrajnim profesional për personat me aftësi ndryshe; ngritje kapacitetesh dhe aftësisesh (kompetencash); programe trajnimi për përditësim kompetencash dhe mjeshtërish; trajnim nëpërmjet punës.
4. **Nxitja e punësimit:** promovimi i ofertave të punës në sektorin publik dhe atë privat; shërbime informimi për punëkërkuessit; banka oferta pune dhe burime online; programe mbështetje dhe kualifikimi profesional dual (edukim & trajnim); programe lehtësuese dhe kalim në formalitet; nxitja e start up dhe vetëpunësimit.
5. **Instituti i kapitalit njerëzor:**- analiza dhe kërkime rreth nevojave të tregut të punës; nxitja e kohezionit social; zhvillimi i punonjësve të rinj dhe të moshuar; menaxhimi strategjik i talenteve; menaxhimi dhe zbatimi i projekteve të fokusuara në çështjet e punësimit; analiza dhe opinione të aktorëve kryesorë me qëllim identifikimin e rekomandimeve dhe përgatitjen e një politike të re nxitjeje të punësimit.
6. **Shërbim konsulence ligjore në:** legjislacionin e punës, politikën e arsimit të fokusuar drejt fuqizimit të kapitalit njerëzor dhe rritjes së qendrueshme
7. **Asistencë nëpërmjet teknologjisë dhe inovacionit:** Krijimi i një platforme komunikimi on-line që u shërben grupeve të interesuara për të nxënë kualifikimin / certifikimin në fushën e aftësive të ekonomisë dhe për zhvillimin e avancuar profesional në fushën e arsimit.

7.1 Klasa *Virtuale*

Klasat virtuale janë versione/ platforma on-line në ‘google class’ dhe ‘google hangouts; takohen, ku të gjithë palët e interesuara, zgjedhin tema për leksione / seminare / trajnime / konferenca, etj, dhe i ndjekin ato.

Sistemi i Menaxhimit të Mësimit është një seksion on-line, ku të gjithë të interesuarit mund të regjistrohen dhe atje ata kanë mundësinë të studiojnë materialet që lidhen me interesat e tyre, por gjithashtu mund të shkarkojnë materialet që dëshirojnë, si dhe mund të regjistrohen për të marrë pjesë në leksione, seminare, ose të tjera. Veprimtaritë mësimore.

Praktikat më të mira është një seksion on-line që prezanton praktikën më të mira që kanë arritur grupet e interesit të cilat u kanë mundësuar atyre që të kenë sukses dhe arritje individuale.

7.2 Duke kërkuar për demonstrime on-line

Është një seksion on-line në të cilin grupet e interesit hyjnë dhe atje gjejnë demonstrime të ndryshme online me imazh dhe zë ose në teknologji të ndryshme të komunikimit, siç janë: video,



regjistrime, ppt, filma, etj, që shpjegojnë konceptet ose praktikat që lidhen me interesat e grupeve të ndryshme.

7.3 Pagesat është një pjesë që paraqet çmimet për secilin shërbim, duke filluar nga:

1. Pagesa për pjesëmarrje në leksione / seminare / trajnime / konferenca
2. Pagesa për kohën e qëndrimit në internet në portal
3. Pagesa për materialet e shkarkuara
4. Pagesa për përdorimin e pajisjeve demo
5. Te tjera: Kurset e ofruara janë çertifikuar nga institucionet shtetërore dhe Universiteti 'Barleti' i cili ka vënë në dispozicion stafin më të mirë akademik për ofrimin e trajnimit. Kjo iniciativë jo vetëm që krijon risi në ofrimin e trajnimeve dhe kurseve me alternativën virtuale, por kërkon të përqëndrohet në trajnime edhe grupet më në nevojë siç janë rinia, gratë, pakicat dhe të kthyerit. Ekziston gjithashtu një grup i veçantë i trajnerëve dhe mësuesve për të cilët është përgatitur një program specifik trajnimi në përputhje me kërkesat e organeve të çertifikimit për aftësimin e mësuesve.

7.4 Realizimi dhe çertifikimi i formimit virtual për:

- Grupet e interesit para se të jenë studentë të studimeve bachelor dhe master;
- Grupet e interesit gjatë shërbimit si mësues, drejtorë të shkollave / kopshteve dhe grupe të tjera të interesit në fushën e ekonomive të punës
- Grupe interesi për të mësuar dhe arritje të larta në gjuhët angleze dhe gjermane
- Nxënësit dhe të rriturit për kompetencat themelore të kurrikulës zyrtare për arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin i mesëm të lartë.
- Grupet e interesit për programet / programet TIK / softuerët / platformat e mësimit on-line
- Grupe interesi për trajnimet drejtuar punonjësve dhe personelit të kompanive dhe bizneseve;

Sektorët kryesorë

Grupi Barleti bazuar edhe në strategjitë dhe politikat qeveritare kushtuar sektorëve prioritarë të zhvillimit me qëllim fuqizimin e kapitalit njerëzor për rritjen e qendrueshme është fokusuar në sektorët e mëposhtëm punëdhënës:

1. Turizmi
2. Ndërtimtaria
3. Mirëmbajtja
4. Informatikë dhe teknologji informacioni
5. Tenikë të mesëm/ mjeshtra
6. Shërbime
7. Mjekësi



8. Bujqësi
9. Edukim
10. Tregti dhe sipërmarrje

REFERENCE

[1] <https://s3platform.jrc.ec.europa.eu/documents/20182/84453/RIS3+Guide.pdf/fceb8c58-73a9-4863-8107-752aef77e7b4>

[2] Enciclopedia Britanica, <https://www.britannica.com/topic/human-capital>, konsultuar më 3.6.2020